



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM
Nr. 145 Datë 22.12.2021.

**PËR PËRDORIMIN E SHITESËS SË FONDIT SIPAS AKTIT NORMATIV NR 34
DATË 3.12.2021 TË MFE, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Plotësues nr. 4 datë 25.1.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, si dhe Aktit Normativ nr 34 datë 3.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 Për buxhetin e vitit 2021, të ndryshuar”, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e përdorimit të shtesës së fondit në vlerën 688,568 lekë, si dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e shtesës së fondit në vlerën 688,568 lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke u nisur nga detyrimi më i vjetër i papaguar, dhe me këtë strukturë buxhetore :

SHTOHET 00 01110 01 Art. 6020000 +688,568 lekë (Prog Planifikim, menaxhim administrim Bashkia)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

